



Parco Aveto



Comune di Borzonasca

- 6) Shërbimi komunal do të kryejë zbrazjen e bidonave të Martën, të Enjten dhe të Shtunën.
- 7) Mbeturinat e tjera të diferencuara jo të riciklueshme (permbajtje të thata) duhet të depozitohen në ishujt ekologjike, të mbyllur në qese të përshtatshme për të evituar derdhjen.

C) MBLEDHJE TË VEÇANTA

Ju kujtojmë që në disa pika të territorit tonë janë të instaluar bidona të posaçëm për bateri, vaj të përdorur dhe ilaçe, mbeturinat e qenve. Përveç këtyre, në disa ishuj ekologjike në Borzonasca Capoluogo, do të vendosen disa bidona ku mund të hidhen pelena (të përdorura nga fëmijë dhe të moshuar) që duhet të ndahen nga pjesa tjetër e mbeturinave dhe që duhet të depozitohen brenda bidonave nga ora 19:00 deri në orën 24:00, të Mërkurën, të Premten dhe të Dielën, dhe të tërhiqen gjatë ditës së nesërme.

Ju kujtojmë gjithashtu, që është në funksionim shërbimi për tërheqjen e materialeve të rënda, të cilët, nëse janë në sasi të kufizuara, mund të depozitohen në ishujt ekologjike çdo ditë të mërkurë të fundit të muajit, dhe prej atje do të tërhiqen gjatë ditës së nesërme, ose mund të depozitohen, edhe me sasi të medha, në qendrën e mbledhjes komunale, ditën e shtunë nga ora 8:00 deri në orën 11:30.

Ditën e Martë është në shërbim mbledhja e kartonit derë më derë në aktivitetet komerciale.

D) PERMBYLLJE

Siç e shihni, me riorganizimin e mbledhjes së mbeturinave, është përballuar çdo problem, duke gjetur përgjigje efektive, të thjeshta dhe me shpenzime të kufizuara, por suksesi do të arrihet vetëm me bashkpunimin tuaj të domosdoshëm, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të arrijmë përqindjen e mbledhjes së diferencuar nga 30% i tanishëm në 65%, që është objektivi i vendosur nga ligji.

Për këtë arsye, nëse mbledhja e diferencuar nuk do të realizohej këtë përqindje pas pak kohe, pasi të jetë verifikuar që firma sipërmarrëse të ketë ndjekur detyrën e saj dhe të ketë bërë të pamundurën që qytetari të jetë një pjesë themelore e projektit, do të japim qytetarëve, me pagesë, qese të posaçme për depozitimin e mbeturinave me përmbajtje të lagësht dhe jo të diferencuara me përmbajtje të thata, të cilat janë të pajisura me barkode identifikimi.

Si pasojë, do të intensifikohen kontrollet administrative mbi mbeturinat e derdhura dhe do të sanksionohen ata që nuk përmbushin detyrimet. Përveç kësaj, do të ketë një rritje të TARI-t për të mbuluar shpenzimet e tepërta.

Kjo është një sfidë, që sëbashku mund të fitojmë, duke diferencuar në mënyrën e duhur dhe zyrat komunale janë në dizpozicionin tuaj për t'ju dhënë të gjitha informacionet e nevojshme, duke mos braktisur mbeturinat jashtë ishujve ekologjike dhe duke

Ditën e Premte, nga ora 19:00 deri në orën 24:00 në zonat: Filanda, Cassetti, Borzonasca Qendër e Pian della Cà, dhe shërbimi komunal i mbledhjes do të bëhet ditën e nesërme. ËSHTË I NDALUAR DEPOZITIMI I MBETURINAVE JASHTË DITËVE TË KAKTUARA.

respektuar ditët dhe oraret e përcaktuara, jo vetëm duke konsideruar aspektin ekonomik ose detyrimet ligjore, por mbi të gjitha për të respektuar ambientin tonë.

Administrata Komunale

Të dashura bashkëqytetare, të dashur bashkëqytetarë.

Të gjithë e njohim çmimin e mbledhjes dhe të trajtimit të mbeturinave qytetare, i cili ka arritur një kosto shumë të lartë, dhe që ne e shohim vazhdimisht në "faturat" e "plehrave".

Ky çmim i lartë është pasojë e një shërbimi mbledhës që duhet të mbulojë një sipërfaqe shumë të madhe dhe një kosto shkarkimi shumë të lartë.

Përveç kësaj, deri në vitin 2013, një pjesë e këtij shërbimi ishte i mbuluar nga tatimet e përgjithshme të Komunës, por duke filluar nga viti 2014, ligji cakton që të gjitha detyrimet e shërbimit duhet të përmbahen në tarifë, me një rritje të pashmangshme.

Theksohet gjithashtu që deponia e mbeturinave në Rezzoaglio, e përdorur nga ne, është e mbyllur duke filluar nga data 15 Janar 2015, sepse ka arritur sasinë maksimale të lejueshme dhe, duke filluar nga kjo datë, duhet të transportojmë mbeturinat tona tek deponia e Rio Marsiglia-s, Komuna e Uscio-s.

Kjo nuk do të thotë që deponia në partneritet nuk ekziston më dhe që nuk na duhet të përballojmë shpenzimet, por përkundrazi dhe fatkeqsisht, duhet të administrohet akoma për një kohë të gjatë, sepse janë ende shumë punë për tu bërë gjatë periudhës së mbylljes, dhe duhet të perballohen shpenzimet e administrimit të mëparshëm, pasoja e të cilave është shpërndarja në tarifa.

Për këtë arsye, për të shmangur rritjen e vazhdueshme të shpenzimeve, nevojitet urgjentisht një reduktim i sasisë së mbeturinave që duhet të përpunohen në impiante, duke diferencuar mbeturinat në mënyrë maksimale.

Për të arritur këtë qëllim, është i domosdoshëm bashkpunimi tuaj, kurse nga ana jonë është i nevojshëm një sistem i ndryshëm mbledhje, duke mos harruar që ligjet në fuqi na detyrojnë të arrijmë të paktën 65% në mbledhjes të diferencuar, kur sot jemi ende në 30%.

Këto janë arsyet për të cilat është riorganizuar mbledhja e mbeturinave urbane duke ndjekur këto modalitete që do të fillojnë nga data 1 Maj 2015.



